

UDHËZIM
Nr. 12, datë 29.9.2014

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 31, DATË 20.1.2001, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I INVALIDIT, PARAPLEGJIK
DHE TETRAPLEGJIK”,
TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, dtë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, i ndryshuar, të pikës 8 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001 “Për përfitimet nga statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar

UDHËZOJ:

1.Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 9 900 (nëntëmijë e nëntëqind lekë në muaj).

2.Masa e përfitimit për kujdestarinë e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 31, datë 20.1.2001, bëhet 10 400 (dhjetëmijë e katërqind lekë në muaj).

3.Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtator i vitit 2014 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2014, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

4.Udhëzimi nr. 5, datë 7.8.2013 i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË

Erion Veliaj